

Njoftim për shtyp

Projekti Ndërkombëtar DINALPCONNECT - Korridori Ekologjik ndërkufitar i Alpeve dhe Maleve Dinarike

Më date 29 Shtator 2020, projekti i ri ndërkombëtar i Interreg ADRION mbi korridoret ekologjike, DINALPCONNECT zyrtarisht nisi punën me një takim virtual i cili mblodhi rreth 40 pjesëmarrës (ekspertë) nga Sllovenia, Kroacia, Italia, Bosnia Hercegovina, Mali i Zi, **Shqipëria** dhe Greqia, pjesë e konsociumit të projektit.

Menaxherja e projektit, znj. **Irena Bertoncelj**, në emër të Institutit Bujqësor të Sllovenisë (i cili është partneri lider i projektit), hapi takimin dhe i prezantoi të gjithë pjesëmarrësit me sfidat që DINALPCONNECT synon të adresojë si dhe me objektivat kryesore të projektit. Ajo theksoi se një pjesë e konsiderueshme e vendeve të Ballkanit Perëndimor është prekur nga rrethana të vështira politike dhe ekonomike që çojnë në pengesa ndërkufitare, që nga ana tjetër, paraqesin sfida për krijimin e një Korridori Ekologjik. Objektivi i ndërhyrjes së projektit është të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe sektorial për të përmirësuar korridorin ekologjik të Alpeve dhe Maleve Dinarike duke mundësuar kështu mbrojtjen afatgjatë të biodiversitetit në funksion të ndryshimeve klimatike aktuale dhe të ardhshme.

"Korridori Ekologjik (KE) promovon lëvizjet e specieve (florës dhe faunës) përgjatë habitateve të gjithë korridorit duke lehtësuar kështu procesin ekologjik që mundëson funksionimin afatgjatë të ekosistemeve, ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e shërbimeve të ekositemit."

Në takimin virtual mori pjesë dhe përfaqësuesi i Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko - Jonian (EUSAIR), Z. **Mitja Bricelj** dhe përfaqësuesja e Strategjisë së BE-së për rajonin Alpin - Znj. **Tina Trampup**. Z. **Mitja Bricelj** e karakterizoi projektin si vendimtar dhe shumë domethënës për Evropën dhe të gjitha vendet e territorit midis Alpeve dhe Maleve Dinarike, si dhe rajonin e Adriatikut dhe Danubit.

"Ne ndodhemi në pikën qendrore të biodiversitetit në Evropë dhe ky është një projekt shumë i nevojshëm për brezat e ardhshëm dhe vetë të ardhmen e Evropës. Jam shumë i lumtur që po trajtoni këto çështje të rëndësishme për të ardhmen dhe që jeni partnerë në strategjinë makro-rajonale evropiane. Është e nevojshme të vendosen korridore blu dhe jeshile midis ekosistemit të Alpeve dhe Maleve Dinarike, të cilat duhet të njihen si zona parandalimi për copëzimin e mëtejshëm të ekosistemit ndërkufitar. Korridoret e Gjelbërta dhe Blu janë një lidhje hapësinore mjedisore e zonave të Infrastrukturës së Gjelbër që ruajnë ose përmirësojnë biodiversitetin, e tipari i tyre themelor është lidhja. Kjo është një mundësi e madhe për të kapitalizuar njohuritë tona dhe unë pres me padurim bashkëpunimin në të ardhmen" - tha Z. Bricelj.

Pjesa e dytë e takimit iu kushtua prezantimit të paketave të punës së partnerëve dhe zonave pilot të projektit bashkë me lidhjet midis tyre.

1. Natura 2000 Kras - Natura 2000 Učka dhe Čićarija (Slloveni - Kroaci);
2. Distrikti i Gjuetisë Tarvisiano - Zona e Menaxhimit të Gjuetisë Triglav / Parku Kombëtar Triglav (Itali - Slloveni);
3. Natura 2000 Lisac - Una NP dhe komuna Drvar (Kroaci - Bosnjë dhe Hercegovinë);

4. Pindusi Verior – Përmet – Kolonjë (Shqipëri - Greqi). Zona pilot në Shqipëri shtrihet në **zonat e mbrojtura dhe jo të mbrojtura të Bashkisë Përmet, Kolonjë dhe Skrapar (Zonat e mbrojtura janë: Parku kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Zona e mbrojtur natyrore Piskal-Shqeri dhe Rezerva Natyrore e Menaxhuar Gërmenj-Shelegur).**

Projekti DINALPCONNECT filloi në janar të vitit 2020 dhe pritet të përfundojë në qershor të vitit 2022. Projekti po zbatohet brenda Thirrjes së Dytë të “Programit të Bashkëpunimit Territorial INTERREG Adriatiko - Jonian 2014-2020” i cili financohet nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal (ERDF) dhe Instrumenti i Asistencës së Para-anëtaresimit (IPA).

Partneriteti i projektit bazohet në një qasje të trefishtë spirale që në këtë rast përfaqëson bashkëpunimin e institucioneve publike, institucioneve private jofitimprurëse dhe institucioneve kërkimore të cilat pritet të gjejnë qasje të përbashkët, sinergjike për zbatimin e projektit. Ky partneritet përbëhet nga 11 partnerë të cilët vijnë nga 7 vende:

- Instituti bujqësor i Sllovenisë (AIS) si partneri Lider;
- Shoqata BIOM;
- Shërbimi për pyjet Slloven (SFS);
- Parku Natyror Julian Prealps (PNPG);
- Natura Jadera
- OJQ Dinarica
- **Partnerë në Zgjidhje dhe Zhvillim (DSA)**; (Partneri Shqiptar dhe institucioni i asociuar: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (**AKZM**))
- Universiteti Bujqësor i Athinës (AUA);
- Akademia Evropiane e Bozen (EURAC Research);
- Center for Energy, Environment and Resources (CENER 21);
- Ministry of Agriculture and Rural Development

Projekti pritet të zgjerojë kapacitetet ndërkombëtare në trajtimin e cenueshmërisë mjedisore, copëzimit dhe ruajtjen e shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatiko-Jonian, përmes këtyre rezultateve kryesore:

- Krijimi i një Strategjie për përmirësimin e KE (përmes lidhjes së Maleve Dinarike me Alpet);
- Ndërtimi i Planeve të Veprimit për rajonet pilot (promovimi i KE në nivel ndërkombëtar) dhe
- Ngritja e Rrjetit ndërkufitar të rajoneve pilot

Edhe pse takimi u krue online, jemi të bindur se takimi ishte mjaft motivues për të gjithë pjesëmarrësit.

Për përditësime ju lutem na ndiqni në [website](#), [social media](#) dhe [subscribe to our newsletter](#).

Kontakte të Partnerit Shqiptar (DSA): Email: info@dsa.org.al website: www.dsa.org.al